

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“HAZIZI GROUP” SH.P.K.

Sot, më date **29/ 12 / 2020**une e nenshkruara:

- **Rovena Hazizi** lindur me 26/12/1995,shtetase shqiptare, me residence ne Fier,fshati Strum, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar..;në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “HAZIZI GROUP” **SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “HAZIZI GROUP” **SH.P.K.**

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Fshati Strum , pasuria me nr. 3/9, zona kadastrale 3532, Qarku Fier. Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë vendin.

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: rovenahazizi@icloud.com
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- b. Prodhim te produkteve bujqesore ne ambjente te mbrojtura (sera) dhe fushe te hapur, etj. Perpunim, ambllazhim, seleksionim, Import – Eksport i Frutave – Perimeve dhe mallrave te ndryshem.

-Megjitheate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5



Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **150.000** (Njëqind e pesëdhjete mije) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortakja themeluese **Znj. Rovena Hazizi**: Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **150.000** (Njëqind e pesëdhjete mije) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund të behet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asmblesë

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të transferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen në statutin e shoqërisë.



Neni 9

Administrimi

Aministratore e shoqerise emerohet Znj. **Rovena Hazizi** lindur me 26/12/1995, shtetase shqiptare, me residence ne Fier, fshati Strum, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe pergjegjesite e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjastimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqerise

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise ne përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM

Rovena Hazizi

Rovena Hazizi 